



Recommendation of the Committee of Ministers to member states on the management by prison administrations of life sentence and other long-term prisoners

Unofficial translation into Albanian

Recommandation du Comité des Ministres aux Etats membres concernant la gestion par les administrations pénitentiaires des condamnés à perpétuité et des autres détenus de longue durée

Traduction non officielle en albanais

Rekomandimi Rec(2003)23 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me menaxhimin nga administrata e burgjeve të të burgosurve me dënim të përjetshëm dhe afatgjatë

© Council of Europe, original English and French versions

Text originated by, and used with the permission of, the Council of Europe. This unofficial translation is published by arrangement with the Council of Europe, but under the sole responsibility of the translator.

* * * * *

© Conseil de l'Europe, versions originales en anglais et français

Le texte original provient du Conseil de l'Europe et est utilisé avec l'accord de celui-ci. Cette traduction est réalisée avec l'autorisation du Conseil de l'Europe mais sous l'unique responsabilité du traducteur.

KËSHILLI I EVROPËS KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimi Rec(2003)23 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me menaxhimin nga administrata e burgjeve të të burgosurve me dënim të përjetshëm dhe afatgjatë

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 tetor 2003
në mbledhjen e 855-të të Përfaqësuesve të Ministrave)*

Komiteti i Ministrave, në bazë të kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke pasur parasysh se është në interesin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për të përcaktuar parime të përbashkëta në lidhje me ekzekutimin e dënimeve me heqje lirie, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë;

Duke pasur parasysh që ekzekutimi i dënimeve me heqje lirie kërkon gjetjen e ekuilibrit ndërmjet objektivave për të garantuar siguri, rregull të mirë dhe disiplinë në institucionet penale, nga njëra anë, si edhe për të siguruar kushte jetese të denja për të burgosurit, regjime aktive dhe përgatitje konstruktive për lirimin e tyre, nga ana tjetër;

Duke pasur parasysh që të burgosurit duhet të menaxhohen në mënyra që përshtaten me rrethanat individuale dhe konsistente me parimet e drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;

Referuar rezolutës për zbatimin e dënimeve afatgjata të miratuar në tetor 2001 nga Ministrat Evropianë të Drejtësisë gjatë Konferencës së 24-t të tyre të zhvilluar në Moskë;

Duke pasur parasysh se shfuqizimi i dënimit me vdekje në shtetet anëtare ka rezultuar në rritje të dhënies së dënimeve të përjetshme;

Me shqetësimin për rritjen, në shumë vende, të numrit dhe gjatësisë së dënimeve afatgjata, që kontribuojnë në mbipopullim të burgjeve dhe mund të cenojnë menaxhimin efektiv dhe njerëzor të të burgosurve;

Duke pasur parasysh faktin se zbatimi i parimeve që parashikon Rekomandimi nr. R (99) 22 në lidhje me mbipopullimin në burgje dhe fryrjen e popullsisë në burgje, si edhe sigurimin e burimeve dhe stafit adekuat për administratat e burgjeve, do të pakësonin në një masë të rëndësishme problemet e menaxhimit që lidhen me burgimin afatgjatë dhe do të mundësonin kushte burgosjeje më të sigurta dhe të mira;

Duke pasur parasysh se legjislacioni dhe praktika në lidhje me menaxhimin e të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mishëruara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencën e organeve të ngarkuara me zbatimin e saj;

Duke pasur parasysh rëndësinë e parimeve që parashikojnë rekomandimet e mëparshme dhe sidomos:

- Rekomandimin Rec(82)16 për leje nga burgu;
- Rekomandimin Rec(82)17 në lidhje me burgimin dhe trajtimin e të burgosurve të rrezikshëm;
- Rekomandimi Nr. R (84) 12 në lidhje me të burgosurit e huaj;
- Rekomandimi Nr. R (87) 3 për Rregullat Evropiane të Burgut;
- Rekomandimi Nr. R (87) 20 për reagimet sociale ndaj delinkuencës së të rinjve;
- Rekomandimi Nr. R (89) 12 për edukimin në burg;
- Rekomandimi Nr. R (92) 16 për rregullat evropiane për sanksionet dhe masat komunitare;
- Rekomandimi Nr. R (97) 12 për personelin që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave;
- Rekomandimi Nr. R (98) 7 në lidhje me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burgje;
- Rekomandimi Nr. R (99) 22 në lidhje me mbipopullimin në burgje dhe fryrjen e popullsisë në burgje;
- Rekomandimi Rec(2000)22 për përmirësimin e zbatimit të Rregullave Evropiane për sanksionet dhe masat komunitare;
- Rekomandimi Rec(2003)22 për lirimin me kusht;

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

- të udhëhiqen nga parimet e përcaktuara në shtojcën e këtij rekomandimi në legjislacionin, politikat dhe praktikën e tyre mbi menaxhimin e të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë,
- të garantojnë që ky rekomandim dhe raporti shoqëruar të shpërndahen sa më shumë.

Shtojca e Rekomandimit Rec(2003)23

Përkufizim i të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë

1. Për qëllime të këtij Rekomandimi, një i burgosur i përjetshëm është i burgosuri që kryen dënimin me burgim të përjetshëm. I burgosur afatgjatë është i burgosuri që kryen një apo disa dënime me burg që së bashku arrijnë pesë ose më shumë vite.

Objektivat e përgjithshëm

2. Qëllimi i menaxhimit të të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë duhet të jetë:

- të garantojë se burgjet janë një ambient i siguar dhe i sigurtë për këta të burgosur dhe për të gjitha ata që punojnë me ta apo u bëjnë vizita;
- të zbutë efektet dëmtuese të burgimit të përjetshëm apo afatgjatë;
- të rritë dhe të përmirësojë mundësitë për këta të burgosur që të ri-kthehen në shoqëri dhe të bëjnë një jetë konform ligjit pas lirimit të tyre.

Parime të përgjithshme për menaxhimin e të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë

3. Të konsiderohet shumëllojshmëria e veçorive personale të të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë , dhe ky fakt duhet të mbahet parasysh me qëllim që të hartohen plane individuale për ekzekutimin e dënimit (parimi i individualizimit).
4. Jeta në burg duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të përngjajë sa më shumë me jetën reale në komunitet (parimi i normalizimit).
5. Të burgosurit duhet t'i jepet mundësia të ushtrojë përgjegjësinë personale në jetën e përditshme në burg (parimi i përgjegjësisë).
6. Duhet të bëhet dallim i qartë i rrezikut që paraqesin të burgosurit e përjetshëm dhe afatgjatë ndaj komunitetit të jashtëm, vetes, të burgosurve të tjerë dhe personave që punojnë në apo që vizitojnë burgun (parimi i sigurisë dhe sigurimit).
7. Duhet të mbahet parasysh që të dënuarit e përjetshëm dhe ato afatgjatë të mos veçohen mbi bazën e vetme të dënimit të tyre (parimi i mos-veçimit).
8. Planifikimi individual për menaxhimin e dënimit të përjetshëm ose afatgjatë të të burgosurit duhet të synojë garantimin e lëvizjes progresive përmes sistemit të burgjeve (parimi i progresionit).

Planifikimi i dënimit

9. Për secilin të burgosur duhet të hartohet një plan dënimi gjithëpërfshirës, me qëllim arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe respektimin e parimeve të parashtruara më lart. Këto plane duhet të përgatiten dhe të hartohen sa më shumë me pjesëmarrjen aktive të të burgosurit dhe, veçanërisht nga fundi i periudhës së dënimit, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet që ushtrojnë mbikëqyrjen pas lirimimit dhe autoritetet e tjera përkatëse.
10. Plani i dënimit duhet të përfshijë një vlerësim rreziku dhe nevojash për çdo të burgosur, dhe duhet të shërbejë për të pasur një qasje sistematike për:
 - sistemimin fillestar të të burgosurit;
 - lëvizjen progresive përmes sistemit të burgjeve nga kushte më shumë kufizuese në më pak kufizuese dhe, në rastin ideal, në një fazë përfundimtare në kushte të hapura, mundësisht në komunitet;
 - pjesëmarrjen në punë, arsimim, formim profesional dhe aktivitete të tjera që ofrojnë shfrytëzim kuptimplotë të kohës së kaluar në burg dhe rrisin probabilitetin për një rikthim të suksesshëm pas lirimimit;
 - ndërhyrjet dhe pjesëmarrjen në programe të projektuara për të adresuar risqet dhe nevojat, me qëllim që të reduktohet sjellja e shqetësuese në burgje dhe recidivizmi pas lirimimit;
 - pjesëmarrjen në aktivitete argëtuese dhe të tjera, me qëllim parandalimin apo zbutjen e efekteve të dëmshme të burgimeve afatgjata;

— kushtet dhe masat mbikëqyrëse që synojnë që i liruari me kusht të bëjë një jetë konform ligjit dhe të përshtatet në komunitet

11. Planifikimi i dënimit duhet të fillojë sa më herët pas futjes në burg, të shqyrtohet në intervale kohore të rregullta dhe të modifikohet sipas nevojës.

Vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave

12. Administrata e burgut duhet të kryej një vlerësim të kujdesshëm për të përcaktuar nëse të burgosur të caktuar paraqesin rrezik për veten e tyre dhe të tjerët. Gama e rreziqeve të vlerësuar duhet të përfshijë lëndimin e vetes, dhe të burgosurve të tjerë, personave që punojnë ose vizitojnë burgun, ose komunitetin, dhe mundësisë për arratisje, ose të kryerjes së një veprë tjetër serioze si gjatë burgimit ashtu edhe pas lirit.

13. Vlerësimi i nevojave duhet të synojë identifikimin e nevojave personale dhe veçorive që lidhen me veprat e kryera nga të burgosurit dhe sjellen e dëmshme (“nevojat kriminogjenike”). Nevojat kriminogjenike duhet të adresohen në maksimumin e mundshëm, në mënyrë që të pakësojnë veprat dhe sjelljet e dëmshme nga të burgosurit si gjatë ashtu edhe pas lirit.

14. Vlerësimi fillestar i rrezikut dhe i nevojave duhet të kryhet nga një personel i trajnuar në mënyrën e duhur dhe mundësisht të kryhet në një qendër vlerësimi.

15.a. Duhet të përdoren instrumente bashkëkohore të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave si udhërrëfytes të vendimeve për ybatimin e dënimeve të përjetshme ose afatgjata.

b. Meqenëse instrumentet e vlerësimit të rrezikut dhe të nevojave përfshijnë gjithmonë një hapsirë gabimi, ato nuk duhet të jenë asnjëherë metoda e vetme për të bazuar vendimmarrjen por duhet të plotësohen nga forma të tjera vlerësimi.

c. Të gjitha instrumentet e vlerësimit të rrezikut dhe nevojave duhet të vlerësohen në mënyrë që të njihen forca dhe dobësitë e tyre.

16. Duke qenë se as rrezikshmëria as edhe nevojat kriminogjenike nuk janë veçori në thelb të qëndrueshme, vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave duhet të përsëritet në intervale nga personel i trajnuar në mënyrë të duhur për përmbushur kërkesat e planifikimit të dënimit ose kur të jetë në të kundërt e nevojshme.

17. Vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave duhet të lidhet gjithmonë me menaxhimin e rrezikut dhe të nevojave. Këto vlerësime duhet të përcaktojnë ndërhyrjen e zgjedhur ose modifikimin e tyre që janë në zbatim.

Siguria dhe sigurimi në burgje

18. a. Kontrolli në burg duhet të bazohet në përdorimin e sigurisë dinamike, që do të thotë vendosja nga stafi i marrëdhënieve pozitive me të burgosurit bazuar në vendosmëri dhe ndershmëri, të ndërthurura me një vetëdije për situatën e tyre personale dhe çdo rrezik që mund të paraqesë secili i burgosur.

b. Për sa i përket pajisjeve teknike si alarme apo televizorë me qark të mbyllur, këto duhet të jenë gjithmonë të lidhura me metoda dinamike të sigurisë.

c. Brenda caqeve të nevojshëm për sigurinë, duhet të ndalohet brenda perimetrit të burgut mbajtja rutinë e armëve, përfshi armët e zjarrit dhe shkopinjtë e gomës nga personat në kontakt me të burgosurit.

19. a. Regjimet e burgut duhet të organizohen në mënyrë të tillë që të lejojnë reagime fleksibël ndaj ndryshimit të kërkesave të sigurisë dhe sigurimit.

b. Sistemimi në një burg apo seksion burgu duhet të bazohet në vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut dhe nevojave dhe rëndësisë së vendosjes së të burgosurve në mjedise, që duke pasur parasysh nevojat e tyre, kanë probabilitet reduktimin e rrezikut që ata paraqesin.

c. Veçimi i ndonjë të burgosuri mund të bëhet i nevojshëm si rezultat i rreziqeve të veçanta apo rrethanave të jashtëzakonshme, ose kur kjo kërkohet nga vetë i burgosuri. Duhet bërë përpjekje intensive për të shmangur veçimin ose për ta shkurtuar periudhën e përdorimit të tij, nëse duhet të zbatohet.

20. a. Sistemimi i të burgosurve në njësitë e sigurisë maksimale duhet të zbatohet vetëm si opsion i fundit dhe duhet të shqyrtohet periodikisht.

b. Brenda njërive të sigurisë maksimale, regjimet duhet të jenë të ndara për trajtimin e të burgosurve që paraqesin një rrezik të jashtëzakonshëm për arratisje ose rrezik nëse në fakt arratisen, edhe atyre që paraqesin rrezik ndaj të burgosurve të tjerë dhe/ose atyre që punojnë apo vizitojnë burgjet.

c. Për sa i përket sjelljes së të burgosurve dhe kriterëve të sigurisë, regjimet në njësitë e sigurisë maksimale duhet të synojnë vendosjen e një atmosfere të qetë, të lejojë shoqërimin mes të burgosurve, lirinë e lëvizjes brenda njësisë dhe të ofrojë një sërë aktivitetesh.

d. Menaxhimi i të burgosurve të rrezikshëm duhet të udhëhiqet nga parimet e mishëruara në Rekomandimin Nr R (82) 17 në lidhje me burgosjen dhe trajtimin e të burgosurve të rrezikshëm.

Zbutja e efekteve dëmtuese të burgimit të përjetshëm apo afatgjatë

21. Për parandalimin dhe zbutjen e efekteve të dëmshme të burgimit të përjetshëm apo afatgjatë, administratat e burgjeve duhet të përpiqen që:

- në fillim të dënimit dhe më vonë sipas nevojës, t'iu shpjegohen të burgosurve rutina dhe rregullat e burgut, detyrimet dhe të drejtat e tyre;
- t'iu japin të burgosurve mundësinë të zgjedhin vetë për sa më shumë çështje të jetës së përditshme në burgje;
- të sigurojnë kushte materiale adekuate dhe mundësi për stimulim fizik, intelektual dhe emocional;
- të krijojnë një projekt të këndshëm dhe praktik të ambienteve të burgjeve, mobilimit dhe dekorimit.

22. Përpyjekje të veçanta duhen bërë për të parandaluar shkëputjen e lidhjeve familjare. Për këtë qëllim:

- të burgosurit duhet të sistemohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në burgje që ndodhen sa më pranë familjeve apo rrethit të tyre të ngushtë familjar;
- letrat, telefonatat dhe vizitat duhet të lejohen me maksimumin e mundshëm të shpeshësisë dhe privatësisë . Nëse kjo cenon sigurimë dhe sigurimin , apo kur justifikohet nga një vlerësim rreziku , këto kontakte mund të shoqërohen me masa sigurie të arsyeshme, si monitorimi i letërkëmbimit dhe kontrollet para dhe pas vizitave.

23. a. Gjithashtu, duhet të përkrahen kontaktet e tjera me botën e jashtme, si gazetat, radioja dhe televizioni dhe vizitorët e jashtëm.

b. Përpyjekje të veçanta duhen bërë për të mundësuar dhënien e formave të ndryshme të lejeve nga burgju, nëse është e nevojshme nën shoqërim, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në Rekomandimin Nr R (82) 16 për lejen nga burgju.

24. Të burgosurit duhet të kenë akses të përshtatshëm në këshillim, ndihmë dhe mbështetje, me qëllim që:

- të kuptojnë veprën penale që kanë kryer, dëmin që i kanë shkaktuar viktimave si edhe ndjenjën e fajit, nëse ka;
- të ulët rreziku i vetëvrasjes, sidomos menjëherë pas dënimit;
- të zbuten efektet e dëmshme të burgimit afatgjatë, si institucionalizimi, pasiviteti, rënia e vetëbesimit dhe depresionit.

Kategoritë e ndryshme të të burgosurve të përjetshëm dhe afatgjatë

25. Autoritetet e burgut duhet të mbajnë parasysh mundësinë e riatdhesimit të të burgosurve të huaj, siç parashikon Konventa Evropiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar apo marrëveshjet dypalëshe me vendin përkatës. Të burgosurit e huaj duhet të informohen për këto mundësi. Kur riatdhesimi nuk është i mundur, menaxhimi dhe praktikat në burgje duhet të udhëhiqen nga parimet e Rekomandimin Nr R (84) 12 lidhur me të burgosurit e huaj.

26. Duhet të bëhen përpjekje për të mbrojtur të burgosurit e cenueshëm nga kërcënimet dhe keqtrajtimet e të burgosurve të tjerë. Nëse veçimi mbrojtës është i nevojshëm nga të burgosurit e tjerë, duhet të shmanget izolimi i plotë dhe të garantohet mjedis i sigurt dhe përkrahës.

27. Duhet të merren masa për të mundësuar diagnostikim të hershëm dhe të specializuar të të burgosurve që kanë - apo bëhen me çrregullime mendore dhe t'iu sigurohet trajtim adekuat. Duhet të ndiqet orientimi i dhënë në Rekomandimin Nr R (98) 7 lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg.

28. Të burgosurit e moshuar duhet të ndihmohen për të ruajtur standardet e mira të shëndetit fizik dhe mendor. Për këtë qëllim, administrata e burgut duhet t'iu sigurojë:

- shërbime të përshtatshme diagnostikimi dhe kurimi;

- mundësi për pune, ushtrime dhe aktivitete të tjera të përshtatshme për kapacitetet fizike dhe mendore të secilit të burgosur;
- vakte me dietë të përshtatshme, duke pasur parasysh nevojat dietike të posaçme të tyre.

29. a. Në mënyrë që të burgosur me sëmundje vdekjeprurëse të vdesin me dinjitet, duhet të shihet mundësia që të lirohen në mënyrë që dikush të kujdeset për ta dhe të vdesin jashtë burgut. Në çdo rast, administrata e burgut duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t'iu dhënë këtyre të burgosurve dhe familjeve të tyre mbështetjen dhe kujdesin e duhur.

b. Këtyre të burgosurve u duhet dhënë ndihma e duhur për veprime praktike që dëshirohen prej tyre, për shembull me hartimin e testamentit, përgatitjet për funeral, etj.

30. a. Meqë gratë përbëjnë pakicën e të burgosurve të përjetshëm apo afatgjatë, planifikimi i dënimit të tyre individual duhet të bëhet me kujdes që të përmbushë nevojat e tyre specifike.

b. Përpjekje të veçantë duhen bërë për të burgosurat me qëllim që:

- të shmangët izolimi shoqëror duke i përzier sa më shumë me popullsinë e përgjithshme të të burgosurave;
- t'iu ofrohen shërbime të veçanta të burgosurave që kanë qenë objekt i abuzimit fizik, mendor apo seksual.

c. Nënave që shlyejnë dënim të përjetshëm apo afatgjatë nuk iu duhet mohuar mundësia për të pasur fëmijët e vegjël me vete, vetëm për shkak të dënimit të tyre. Kur fëmija i vogël i besohet nënës, administrata e burgut duhet t'iu sigurojë kushte të përshtatshme.

31. Kujdes i veçantë menaxhimi dhe vëmendje duhet t'i kushtohet problemeve të veçanta të paraqitura nga të burgosurit që kanë gjasa të kalojnë jetën e tyre në burg. Në veçanti, planifikimi i dënimit të tyre duhet të jetë mjaft dinamik dhe të lejojë që ata të përfitojnë nga pjesëmarrja në aktivitete kuptimplota dhe programet e duhura, duke përfshirë ndërhyrje e shërbime psikosociale të dizajnuara për të ndihmuar ata të përballen me të dënimit të tyre.

32. a. Të burgosurit e mitur me dënime të gjata me burgim duhet të mbahen vetëm në institucione ose njësi të projektuar për nevojat e tyre të veçanta.

b. Regjimet dhe planifikimi i dënimit për këta të mitur duhet të udhëhiqet nga parimet përkatëse të përcaktuara në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe në Rekomandimin Nr. R (87) 20 për reagimet sociale ndaj delinkuencës së të miturve, edhe t'i kushtohet vëmendje e veçantë:

- dhënies së edukimit dhe shkollimit adekuat;
- nevojës për të pasur kontakte të ngushta me prindërit dhe familjarët;
- dhënies së mbështetjes adekuate dhe orientimet në zhvillimin emocional;
- ofritit të aktiviteteve të duhura sportive dhe argëtuese;
- planifikimit të kujdesshëm të kalimit të të miturit në regjimin e të rriturve, duke mbajtur parasysh siç duhet zhvillimin personal të të miturit.

Menaxhimi i ri-integrimit në shoqëri të të burgosurve të përjetshëm dhe afatgjatë

33. Me qëllim që të burgosurit e përjetshëm dhe afatgjatë të kapërcejnë problemin e kalimit nga burgosja e gjatë në një jetë konform ligjit në komunitet, lirimi i tyre duhet të përgatitet herët në kohë dhe duhet të ketë parasysh në mënyrë të veçantë:

- nevojën për plane para dhe pas lirimit që adresojnë risqe dhe nevoja relevante;
- mundësinë për arritjen e lirimit dhe vazhdimin pas lirimit të ndonjë programi, ndërhyrjeje apo trajtimi që të burgosurit kanë marrë gjatë burgosjes;
- nevojën për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet administratës së burgjeve dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen pas lirimit, shërbimeve sociale dhe mjekësore.

34. Miratimi dhe zbatimi i lirimit me kusht për të burgosurit e përjetshëm dhe afatgjatë duhet të udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në Rekomandimin Rec(2003)22 për lirin me kusht.

Të burgosurit e kthyer

35. Nëse, pas revokimit të lirimit me kusht, një i burgosur i përjetshëm ose afatgjatë kthehet në burg, parimet e renditura më lart duhet të vazhdojnë të respektohen. Në veçanti, duhet të kryhet një vlerësim i mëtejshëm i rrezikut dhe nevojave kriminogjenike dhe të përdoret për të zgjedhur sistemimin e përshtatshëm dhe ndërhyrje të mëtejshme, me qëllim përgatitjen e të burgosurit për mundësinë e lirimit të parakohshëm dhe rikthimin në komunitet.

Staff

36. Në përgjithësi, rekrutimi, përzgjedhja, trajnimi, kushtet e punës dhe mobilitetit, si edhe sjellja profesionale e personelit që merret me të burgosurit e përjetshëm dhe afatgjatë duhet të udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në Rekomandimin Nr. R (97) 12 për personelin që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave;

37. a. Meqë personelit që merret me të burgosurit e përjetshëm dhe afatgjatë duhet të përballlet me vështirësi specifike që paraqesin këta të burgosur, atyre duhet t'iu sigurohet trajnim i specializuar i nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre.

b. Në veçanti, personeli duhet të trajnohet për të pasur plotësisht të qartë nocionin e sigurisë dinamike, me qëllim që ta përdorin këtë qasje ndaj sigurisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

c. Personeli i nivelit drejtues, specialist dhe mbikëqyrës duhet të trajnohet, veç të tjerash, edhe si të mbikëqyrë dhe të mbështesë personelin e nivelit bazë në përdorimin e sigurisë dinamike.

38. Duhet të nxitet lëvizshmëria dhe rotacioni i personelit, për shkak të rritjes së rrezikut të manipulimit të personelit prej të burgosurve afatgjatë,

39. Duhet të organizohen takime dhe diskutime periodike ndërmjet kategorive të ndryshme të personelit, me qëllim që të arrihet dhe të ruhet ekuilibri ndërmjet mirëkuptimit solidar të problemeve të të burgosurit dhe vendosmërisë në kontroll.

Hulumtimi

40. Duhet të bëhen hulumtime mbi efektet e dënimeve të përjetshme dhe afatgjata, duke iu referuar veçanërisht rolit që luajnë faktorët që pengojnë efektet e dëmshme dhe nxisin përshtatjen konstruktive me jetën në burg.

41. Duhet të kryhen dhe të publikohen hulumtime vlerësuese për efektivitetin e programeve që synojnë të përmirësojnë përshtatjen në komunitet pas lirimit.